



## PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 17.06.2022, me fillim në ora 11:30. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

**Kryesuesi** – Fillimi shëndetës më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, nënkyetarin **Fatmir Iska**, të nderuar anëtarë të komitetit për politikë dhe financa, drejtore të drejtorive, zyrtarë komunal, e hapim mbledhjen e 5-të të rregullt të komitetit për politikë dhe financa.

Të nderuar anëtarë të KPF-së për këtë mbledhje propozoj këtë:

## **REND DITE**

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00369-0 në zonën kadastrale Mrasor;
3. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00759-0 në zonën kadastrale në Retijë;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00377K-0, 00444K-0 dhe 02214K-0 në zonën kadastrale Xërxe;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik –P-01830-0, zona kadastrale Rahovec;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik –P-01043-1, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2, zona kadastrale Xërxe;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik – P-01038-2, 0155-2, 01034-0, 01045-0, 01033-2, 01044-0, 01040-0, 01036-2, zona kadastrale Xërxe;
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendror për interes publik;
9. Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore (KAB) 2023-2025 dhe qarkores buxhetore 2023/1;
10. Informatë nga drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural;
11. Të ndryshme

**Kryesuesi** – Ky është rendi i ditës për mbledhjen e KPF-së për sot, ka dikush ndonjë propozim apo përligimin e ndonjë pike nga rendi i ditës...nëse jo vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës... kush është për?...me shumicë votash aprovohet rendi i ditës. Vazhdojmë me pikën e parë

**1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, dikush ndonjë ankesë rrith procesverbalit? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për miratimin e pikës së parë të rendit të ditës? Me shumicë votash aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë te pika e dytë;**

**2. Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00369-0 në zonën kadastrale Mrasor, e ftoj drejtorin Afrim Oruqi që ta prezantoj këtë pikë të rendit të ditës.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, kolegë drejtorë, anëtarë të KPF-së, para jush kemi materialin fizik për zonë kadastrale në Mrasor me parcelën me nr: 369-0 me sipërfaqe të përgjithshme është 1ha e 6ari e 10m katror dhe po kërkojmë nga ju që ta shpallim me interes të përgjithshëm vetëm pjesën e parcelës me sipërfaqe prej 2 ari e 40m katror. Me datë 03 qershor kemi promovuar atje një shtëpi-muze të dëshmorit Skender Rexhepi, qëllimi i shpalljes në interes të përgjithshëm të kësaj parcele është që pronarët e kësaj prone të vijnë në komunë ta falin këtë pronë më pas të kaloj në pronë të kuvendit komunal të Rahovecit.

**Burim Krasniqi** – Drejtor, meqenëse është pronë private (mesa e kuptova), parashihet të ketë kompentim apo është në dakordim me familjarët, pa e kontestuar rëndësinë e asaj, vetëm si informatë a do të ketë kompenzim, apo është dakordim me familjarët e dëshmorit për ndërtimin e shtëpisë-muze.

**Afrim Oruqi** – Në pyetjen e kuvendarit Burim Krasniqi në lidhje me këmbim ose shpronësim, jo nuk do të ketë as këmbim as shpronësim, do të ketë falje të kësaj sipërfaqe nga pronari i pronës.

**Kryesuesi** - Faleminderit drejtor, po e vendosim në votim pikën e dytë të rendit të ditës, kush është për?...me shumicë votash aprovohet edhe pika e dytë e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e tretë;

**3. shqyrtimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-00369-0 zonë kadastrale Retijë, drejtori Afrim Oruqi e ka fjalën edhe një herë për prezantimin e pikës.**

**Afrim Oruqi** – Faleminderit kryesues, të nderuar kuvendar, para jush keni materialin për zonë kadastrale në Retijë, bëhet fjalë për parcelë me nr 759-0. Kjo është parcela ku aktualisht janë të varrosur dëshmorët të luftës së fundit në Kosovë, civil dhe martirë. Kjo pronë në emër të Iliacvetka Nikolic, qëllimi i këtij propozimi për interes të përgjithshëm është se pas shpalljes ne tentojmë të kemi kontakte me këta pronarë e më pastaj të këmbejmë ose të shpronësojmë sepse këtu janë të varrosur viktima e lulës së fundit në Kosovë.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, dikush prej anëtarëve të kuvendit ndonjë gjë lidhur me këtë pikë?...nëse jo atëherë e vendosim në votim! Kush është për?...Me shumicë votash aprovohet edhe pika e tretë e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën nr. katër;

**4. Shqyrtimi i propozim vendimit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik të parcelave të poshtëshënuara P-00377K-0, 00444K-0 dhe 02214K-0 në zonën kadastrale Xërxe, e ftojmë drejtorin Erhan Morina për prezantimin e kësaj pike.**

**Erhan Morina** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyetar, të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni materialin për disa parcela që gjenden në fshatin Xërxe dhe se komuna dëshiron t'i shpallë prona me interes të përgjithshëm fillimisht më pastaj do të provojm t'i shpallim edhe si hapësira për biznese, fjalë është për parcelën me nr. të certifikatës 00377K-0 zona kadastrale në Xërxe, në vendin e quajtur T310 me sipërfaqe 10.007m dhe parcela me nr të certifikatës së pronësisë nr 02214K-0 zona kadastrale në Xërxe në vendin e quajtur T310 me sipërfaqe 111.116 m katror. Poashtu deshta të bëjë në korrigim të vogël te pika 2, e tërheqim nga rendi i ditës pikën nr 1.2 faktikisht, sipas certifikatës së pronësisë nr 0444K-0 për shkak se kjo parcelë është edhe në shfrytëzim me qera dhe kërkoj nga kryesuesi që këtë pikë të rendit të ditës ta kalojmë vetëm me pikën 1 dhe 1.3 ndërsa pikën 1.2 të hiqet nga rendi i ditës.

**Rumir Zhuniqi** – Faleminderit kryesues, i nderuar nënkyretar, drejtorë, kolegë asambleistë; unë pata një pyetje këtu te parcelat sepse shkronja (K) nënkupton që janë nën komasacion dhe sipas ligjit pronat që janë në komasacion janë të dedikuara vetëm për bujqësi dhe sa kemi ne të drejtë që këto zona t'i shpallim hapësira për biznese? Kërkoj që në seancën tjetër të kuvendit të kemi një informatë shtesë rrëth kësaj pyetje, faleminderit.

**Burim Krasniqi** – Drejtor, është fjala te “plepat” që i themi ne, te separacioni Makolli, përveç asaj që e tha Rumiri që është në kadastër është fakt që prej informatave që i kam ka qytetar që i kanë në shfrytëzim dy parcela, iu kanë dhënë prej asamblesë apo prej agjensionit të pylltarisë dhe çfarë destinacioni kanë? Qëllimi i qartë i kësaj, unë po e kuptoj që e keni qëllimin për me marrë prej agjensionit të pylltarisë ose prej agjensionit ndërmarrja e pyjeve koretnike që me ik nga procesi i privatizimit, por megjithatë natyra për biznes pajtohem komplet me Rumirin dhe a është ndokush që është duke shfrytëzuar përveç 444, a është ndokush qe e ka të ndarë ndonjë pjesë në kuadër të këtyre parcelave për shfrytëzim?...

**Erhan Morina** – Rumir, për seancën e radhës do të përgatis që sipas planit të PZHK-së se çka parashihet në këtë zonë, ndërsa sa i përket pyetjes së Burimit, qëllimi është që fillimisht ta shpallim si interes të përgjithshëm që mos të keqpërdoret ose mos të shitet nga akp ose dikush tjetër dhe pastaj brenda mundësive ta marrim dhe ta destinojmë si hapësirë për biznese. Sa i përket qirasë, e ka dhënë njërin prej parcelave për shfrytëzim agjensioni pyor, kështuqë komuna jo, a sa i përket certifikatës së pronësisë këto tjerat janë në posedim të agjensionit pyor prej ndërrmarjes koretnik.

**Burim Krasniqi** – Shfrytëzuesit që e kanë marrë në shfrytëzim, e kanë marr vetëm prej 444 apo edhe prej këtyre dy parcelave tjera? Në vendim në pikën 2, qëllimi është për lokacion për biznes, a mund të kthehet mbrapa duke pas parasysh aryetimin që e tha Rumiri që është në kadastër, pra është mirë të shpallet interes të përgjithshëm pa definicionin “për biznes” duke patur parasysh këtë gjë.

**Erhan Morina** – I nderuar edhe një herë po e përsëris, faktikisht një herë do ta shpallim si parcelë me interes të përgjithshëm, pastaj në seancën e radhës do të shikojmë për binesë...

**Kryesuesi** – Atëherë po e vendosim në votim pikën e 4 të rendit të ditës, kush është për?...Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 4 e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e pestë;

**5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik –P-01830-0, zona kadastrale Rahovec, e ftoj njërin nga drejtorët që ta prezantoj këtë pikë.**

**Erhan Morina** – Faleminderit kryesues, të nderuar të KPF-së para jush keni materialin për një pronë të paluajtshme që gjendet në vendit e quajtur “Rasa ispodsellë” më konkretisht te parku “Toni dhe Mici” sipas certifikatës të pronësisë kjo parcelë është pronë e komunës dhe komuna dëshiron t'a jap në shfrytëzim përmes ankandit publik për një periudh afatshkurtë deri në 3 vite, bohet fjalë për parcelën me nr. të certifikatës të pronësisë 01830-0 me sipërfaqe të përgjithshme 5813, mirëpo komuna dëshiron të jep në shfrytëzim vetëm një pjesë të saj me sipërfaqe 232m katror. Qellimi i dhënies në shfrytëzim të këtyre pronave është ruajtja dhe rritja e vlerës së pronave publike komunale si dhe shfrytëzimi për aktivitete biznesore. Çmimi fillestar për dhënien në shfrytëzim të pronës është caktuar me rregulloren për taksa komunale, ftoj anëtarët e KPF-së që ta votojnë këtë pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi** – Drejtor, kam një pyetje, kjo parcelë në cilën pjesë sakt gjindet? Faleminderit...Atëherë po e vendosim në votim pikën e 5-të, kush është për?...me shumicë votash miratohet pika e 5-të e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e gjashtë;

**6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronave të paluajtshme të komunës, personave fizik dhe juridik –P-01043-1, 01035-0, 01039-0 dhe 01036-2, zona kadastrale Xërxe, sfoj edhe një herë drejtorin Erhan Morina për prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës.**

**Erhan Morina** – Faleminderit kryesues, fillimisht deshiroj ta ngrisë një qështje, gjatë përgatitjes së materialin është lëshuar një gabim teknik dhe se unë si sponsorizues i këtyre dy pikave kërkoj nga kryesuesi dhe anëtarët e KPF-së që pikën e rendit të ditës 6 dhe 7 t'i vendosim në një pikë në seancën e rregullt, ideja është që mos të bohen shumë komisione për vlerësimin e këtyre pronave. Po i lexoj dy pikat... Pjesa e depos përfshin 3 parcela, parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01043-1 në zonën kadastrale në Xërxe në vendin e quajtur "Skaja" me kultur kullosë të klasit të tretë me sipërfaqe 5016m katror, parcela sipas certifikatës së pronësisë 01035-0 në zonën kadastrale në Xërxe në vendin e quajtur "Skaja" me sipërfaqe 2252 kulturë arë e klasit të tretë dhe parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01039-0 në zonën kadastrale në Xërxe në vendin e quajtur "Skaja" arë e klasit të katërt me sipërfaqe 6506m katror. Këto dy pika une kam dashiruar të jenë në një pikë të rendit të ditës, por siç ju thash është bërë një gabim teknik. Po i lexoj edhe parcelat tjera që unë konsideroj që janë vazhdimësi e kësaj; parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01038-2 zona kadastrale Xërxe, vendi "Skaja" me kultur të klasit të katërt me sipërfaqe 1231m katror, parcela me certifikatë të pronësisë 01055-2 zona kadastrale Xërxe, vendi "Skaja" me kulturë të kullosës së klasës së dytë me sipërfaqe 362m katror, parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01034-0 zona kadastrale Xërxe, vendi "Skaja" arë e klasit të tretë me sipërfaqe 549m katror, parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01045-0 zona kadastrale Xërxe, vendi "Skaja" arë e klasit të tretë me sipërfaqe 4138 m katror, parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01033-2 në zonën kadastrale Xërxe, vendi "Skaja" arë e klasit të tretë me sipërfaqe 2142m katror dhe parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01040-0 zona kadastrale Xërxe, vendi "Skaja" arë e klasit të katërt me sipërfaqe 400m katror, parcela me nr. të certifikatës së pronësisë 01036-2 zona kadastrale Xërxe vendi i quajtur "Suga kod" me kulturë arë e klasit të katërt me sipërfaqe 1700m kator kjo ishte pika e 7-të, të gjitha këtë parcela kam vendosur ti kemi në një pikë të rendit të ditës, por për shlikat të një lëshimi teknik janë ndarë në dy pika të rendit të ditës prandaj kërkoj nga kryesuesi dhe nga anëtarët e KPF-së të kenë mirëkuptim që në seancën e rregullt të kuvendit këtë dy pika 6 dhe 7 të futen në një pikë të rendit të ditës.

**Kryesuesi** – Atëherë nëse të gjithë anëtarët e KPF-së janë të pajtimit që këto dy pika të inkorporohen në një pikë të vetme për seancën e rregullt, i vendosim në votim të dy pikat së bashku që në seancën tjetër të jetë një pikë e vetme, kush është për? (kërkoj falje, dikush prej anëtarëve nëse ka diqka për të thënë? Burim Krasniqi e ka fjalën.

**Burim Krasniqi** – Faleminderit kryesues. Drejtor, parcelat janë në shfrytëzim prej dikujt deri tash? Në çoftëse po dhe nëse komuna është e kënaqur me shfrytëzuesin a ekziston mundësia ligjore t'i vazhdohet apo duhet patjetër të shkojmë me ankand publik?

**Erhan Morina** – Faleminderit Burim, aktualisht kemi një shfrytëzues që e shfrytëzon këtë pronë, ka kontratë deri në mes të gushtit, e vetmja mënyrë është ta japim përmes ankandit, nuk kemi të drejtë ta vazhdojmë kontratën, faleminderit.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, atëherë po i vendosim në votim të dyja pikat bashk; kush është për?... me shumicë votash aprovohen këtë dy pikë të rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e 8-të;

**8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dhënen e pëlqimit për këmbimin e pronës publike komunale me pronën e institucionit qendoror për interes publik, e ftoj drejtorin Afrim Oruqi për prezantimin e kësaj pike;**

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së, para jush keni materialin që ka të bëjë me marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës publike të komunës me pronën që menaxhohet prej agjensionit pyjor të Kosovës, bëhet fjalë për zonën kadastrale në Pastasel të dy këto prona, prona e agjensionit pyjor dhe prona e kuvendit komunal të Rahovecit gjenden në Pastasel, ne para disa muajve këtu para jush kemi pas një vendim për interes të përgjithshëm me sipërfaqe prej 10 ari me kërkesën e këshillit të fshatit të Pastasëlit me qëllim të ndërtimit të një objekti për zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe të tjera... e paraparë me procedurë ligjore dhe kërkojmë nga ju pëlqim që të këmbejmë këtë sipërfaqe me hapësirë prej 10 ari t'ia marrim agjensionit pyjor dhe t'ia japim agjensionit pyjor në menaxhim pronën komunale e cila gjendet në zonën kadastrale në Pastasel, parcela me nr. 00944-0 dhe parcela me nr.00386-1. Ftoj anëtarët e KPF-së që të votojnë marrjen e pëlqimit për këmbim të pronës. Kryesuesi – Faleminderit drejtor, dikush ndonjë koment për këtë pikë të rendit të ditës? Atëherë po e vendosim në votim pikë e 8-të të rendit të ditës, kush është për?... me shumicë votash aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e nëntë;

**9. Shqyrtimi i kornizës afatmesme buxhetore (KAB) 2023-2025 dhe qarkores buxhetore 2023/1, e ftoj drejtorin e financave z.Afrim Limani për prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës...**

Afrim Limani – Përvjetoretje kryesues, anëtarë të KPF-së dhe të gjithë të pranishmit. Sipas ligjit të financave publike dhe përgjegjësive dhe ligjit të financave të pushtetit lokal me datë 15.05.2022 në adresë të komunës sonë ka arritur qarkorja e parë buxhetore, ku në bazë të këtyre ligjeve janë përcaktuar edhe limitet buxhetore për buxhetin e komunës së Rahovecit 2023 si dhe projekzionet 2024 dhe 2025. Në bazë të qarkores së parë buxheti i komunës së Rahovecit në total është prej 17.748.240eu. Nëse bëjmë një kahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar e shohim që kemi një rritje të buxhetit prej 2.494.580eu. Buxheti është rritur në këto grante; Në grantin e administratës, granti i përgjithshëm buxheti është 7.605.000 në kahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar kemi rritje prej 1.844.000eu. Buxheti për këshillin e Hoçës së Madhe ka një rritje simbolike prej 126eu, në total 25,279 eu, ndërsa te të hyrat vetanake një rritje prej 95.000eu. Buxheti i arsimit ka një ulje, granti total është 5.872.245eu, nëse e krahasonjmë me periudhën e njejtë të vitit të kaluar kemi ulje prej 93.637eu. Buxheti i shëndetësisë ka një rritje në raport me vitin e kaluar prej 648.990eu. Atëherë në bazë të këtyre buxheteve të granteve, grantit të përgjithshëm, të shëndetësisë dhe të arsimit ne si drejtori e financave e kemi bërë një analizë të mirë të buxhetit dhe përafërsisht shpërndarjen e buxhetit e kemi bërë në kategori ekonomike, pozicioni i pagave është i paprekshëm dhe ka një rritje të pozicionit të pagave 580.000eu. Mallra dhe shërbime - 2.203.000 që ka një rritje prej; 468,829, komunalitë janë 370.000 një rritje prej 100.000eu, subvencionet janë 820.000 që kanë një rritje prej 460.000 si dhe investimet kapitale 5.701.000 që kanë një rritje prej 885,570eu. Sa për informimin tuaj duke u nisur nga ajo që kemi pas probleme të ndryshme nga ana e auditorëve te keqklasifikimet, atëherë mallrat dhe shërbimet dhe subvencionet jemi detyruar që ti rrissim në këto vlera në mënyrë që për vitin 2023 mos të kemi fare keqklasifikime. Në bazë të këtyre projekSIONeve ne si komunë kemi përgatitur edhe një dokument strategjik (KAB) në të cilin kemi punuar jashtëzakonisht shumë ku janë të përcaktuara të gjitha prioritetet e qeverisjes komunale në një afat kohor 2023-2025. Pra, qarkorja e parë buxhetore duhet të votohet sipas ligjit të financave dhe përgjegjësive me këto parametra të cilat

janë të caktuara sipas ligjit dhe kuptohet që shpërndarja bëhet sipas një formule të përgjithshme që është në kuadër të këtij ligji.

**Burim Krasniqi** – Drejtor, te (KAB-i) megjithëse në asamble bisedojmë pak më në detale, një gjë që më ka rënë ta shoh; te planifikimet te vlerësimi 2023-2024-25 janë disa departamente që kanë me një farë menyre “kërcime” në 2023 90.000, në 2024- 80.000 në 2025- 90.000 disi një joseriozitet kur e shohim varietetin te vlerësimet buxhetore në KAB duke mos hyrë në detale. Tjetër, kemi te të hyrat, a jemi duke mbledhur taksë në tokë? Sepse sa kam mundur ta shoh te tatimi në pronë kemi rënien të të hyrave ndërvite, ose 2023 parashihet të jetë më pak se 2024 dhe shkon disi ngjajshëm, po kemi rritje të vazhdueshme të tatimit në tokë, a ka filluar të implementohet taksa në tokë? Kemi bërë ndonjë të hyrë deri më tani? Ndoshta nuk është ndonjë shumë e madhe, por mbi 300.000 përafërsisht është si e hyrë që planifikon komuna e Rahovcit.

**Afrim Limani** – Burim, une të thash që bazë të qarkores së parë buxhetore, ne i kemi përgatitur edhe projekcionet buxhetore për 2023-2024 jemi munduar dhe besojmë që është planifikim i sakt, nuk e kuptova mirë pyetjen e parë, por të them të drejtën prioritet i kemi dhënë vitit 2023 sepse projekcionet vazhdimesh ndryshojnë, pa anashkalime brenda limiteve kemi përgatitur edhe buxhetin përafërsisht sepse ne do ta kemi edhe qarkoren buxhetore nr.2 që d.m.th rrallë herë ka ndodhur që të ketë ndonjë ndryshim edhe pse mund të ndodh të ketë. Te pjesa e të hyrave; disa herë e kam thënë që disa limita n'a përcakton ministria e financave fatmirësisht ose fatkeqësisht dhe prioritet i jep 3 kategorive; tatimit në pronë, tatimit në tokë dhe taksave tjera komunale dhe në bazë të limiteve (tavaneve) ne duhet t'i bëjmë lëvizjet e brendshme të taksave ju them shumë sinjerisht që pranifikimi nuk përputhet me realitetin mirëpo jemi detyruar sepse zakonisht këtu ka edhe “ramje” qe iu ka ikur planifikimi. Te pyetja tatimi në tokë; tatimi në tokë aktualisht aplikohet në tatim në parcela d.m.th oborret, tatimi në tokë ende nuk ka filluar së aplikuari, mirëpo aplikohet tatimi në male dhe në livadhe. Sipas ligjit, neveria në mënyrë që t'i lehtësoj qytetarëve ka përdorë këto masa; nëse një ngarkesë tatimore supozojmë, nëse unë e kam 100euro për një parcelë, atëherë është zbritur dhe përpjesëtar në pesë, d.m.th në vitin e parë tatohet për vlerën 100euro 20%, ë vitin e dytë 40% do të thotë për 5 vite vjmë te 100euroshi., për këtë arsyesh që ka një rritje të tatimit në tokë (vetëm te parcelat), ndoshta në vitin 2023 fillon së aplikuari tatimi në tokë (në tokat bujqësore) që aktualisht deri më sot nuk ka filluar.

**Kryesuesi** – Faleminderit drejtor, nëse ka dikush diçka rreth kësaj pike?.. nëse jo atëherë e vendosim në votim, kush është për?...me shumicë votash aprovohet edhe pika e 9-të e rendit të ditës, vazhdojmë me pikën e dhjetë;

#### **10. Informatë nga drejtoria për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural,**

**Kryesuesi** - për shkak të angazhimeve drejtori i bujqësisë mungon, nëse jeni të pajtimit për në seancë të rregullt të kuvendit ta prezantoj këtë pikë të rendit të ditës (materialin e kemi)...Atëherë jemi te pika e 11-të e rendi të ditës;

#### **11. Të ndryshme, nëse dikush prej anëtarëve ka ndonjë kërkesë ose ankesë...?**

**Rumir Zhuniqi** – Kisha propozuar me këtë rast që çdo mbledhje e KPF-së të filloj në ora 11:00.

**Burim Krasniqi** – Unë e kam vetëm një kërkesë kryesues, te çështja e debatit të KPF-së me qytetarë, unë e thash edhe privatisht që dua ta kem një email, kur ka ngjarje që do t'i bëjë asambleja të informohemi me kohë e mos t'i shkruajmë ngjarjet në facebook, mirëkuptim prej juve kryesues, administratës dhe asamblesë komunale. Faleminderit shumë.

Kryesuesi – Faleminderit Burim, sugjerim me vend, besoj që zyra e informimit do të na informojë me kohë për ngjarjet që organizohen prej kuvendit komunal. Faleminderit shumë për pjesëmarrje, deri në mbledhjen tjeter, mirëmbetshi.

Mbl edhja përfundoj në 12:15

Processimbajtësi  
Agim Hoti

